



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Kabineti i Kryetarit
14-111/01-229458/22
Dt. 20.10.2022

Në bazë të nenit 34, paragrafi 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës dhe të nenit 7, paragrafi 2, dhe nenit 18, paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Prishtinës bënë :

SHPALLJE PUBLIKE

Kabineti i Kryetarit

I.POZITA: Ekspert i jashtëm (për të qenë pjesë e komisionit në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit për konkurse të pranimit)

Lloji i vendit të punës: me afat të caktuar, mandat 2 vjeçar

Numri i pozitave: Një (1) ekzekutues

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së ekspertit të jashtëm :

- Diplomë universitare e nivelit Magjistër (Master) në fushën e Menaxhmentit
- Së paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, në fushën profesionale,
- Të mos jetë i emëruar politikisht,
- Të mos jenë shërbyes civil,
- Të mos jenë punëtorë në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente :

- Kopjen e letërnjoftimit,
- CV,
- Dëshmi mbi shkollimin,
- Dëshmi të përvojës së punës,
- Certifikatën që nuk është nën hetime.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues për pranimë janë të përcaktuara me rregulloren përkatëse si në vijim:

- Vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim;
- vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe
- vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë.

Data e shpalljes së konkursit : Nga dt. 20.10.2022 deri me dt. 27.10.2022

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Komisioni vlerësues, pasi të bëjë vlerësimin e aplikacioneve, vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e kërkuara perzgjidhen në listën e ngushtë.